

Siguri

Ekskluzive | Këta janë të dyshuarit për tentim-vrasjen në Gjakovë – 29-vjeçari u plagos me a*më pas një konflikti



Sinjali.com

11 Gusht 2026 08:49



Sinjali ka mësuar identitetin e dy personave të dyshuar për rastin e tentim-vrasjes që ndodhi pasditen e së hënës në Gjakovë, ku një 29-vjeçar mbeti i plagosur me a*më.

Burimet e Sinjalit bëjnë të ditur se të dyshuarit janë **Hilmi Dula** 42-vjeçar dhe **Ariton Dula** 19 vjeçar , ndërsa viktimja është D.G 30 vjeçar.

Ngjarja ka ndodhur më 10 gusht, rreth orës 15:50, në rrugën “Dëshmorët e Hereçit”.

Sipas informacioneve që ka siguruar Sinjali, gjithçka dyshohet se nisi pas një mosmarrëveshjeje verbale mes viktimës dhe njërit prej të dyshuarve. Konflikti më pas eskaloi, me ç’rast dyshohet se është nxjerrë a*ma dhe është shtënë në drejtim të D.G, duke e plagosur në këmbë.

I plagosuri është dërguar për trajtim në Spitalin Rajonal “Isa Grezda” në Gjakovë. Gjendja e tij raportohet stabile dhe jashtë rrezikut për jetë, ndërsa është hospitalizuar në Repartin e Kirurgjisë.

Në vendin e ngjarjes, Policia ka gjetur dhe sekuestruar dy gëzhoja, një predhë dhe një thikë, por a*ma me të cilën dyshohet se është kryer plagosja nuk është gjetur.

Lidhur me rastin, Hilmi Dula është arrestuar dhe, pas intervistimit nga Hetimet Rajonale, me urdhër të Prokurorit të Shtetit është ndaluar për 48 orë.

I dyshuari tjetër, Ariton Dula, pas intervistimit është liruar në procedurë të rregullt.

Rasti është iniciuar si “Vrasje në tentativë”, ndërsa hetimet për zbardhjen e plotë të rrethanave po vazhdojnë.

Shënim: Personat e apostrofuar në këtë artikull prezumohen të pafajshëm derisa fajësia e tyre të mos provohet me vendim të formës së prerë nga gjykata.

Sinjali – aty ku e vërteta flet para lajmit!

/GazetaSinjali/

Sinjali

Gazeta Sinjali mirëmbahet nga kompania "Sinjali" sh.p.k. Materialet dhe informacionet e Gazetës Sinjali nuk mund të kopjohen, të shtypen, ose të përdoren në çfarëdo forme tjetër, pa leje nga redaksia.



Lajme

Zgjedhjet 2026
Kosovë
Shqipëri
Rajon
Diasporë
Evropë
Botë

Aktualitet

Politikë
Drejtësi
Siguri
Shëndetësi
Arsim
Sociale

Hulumtime

Ekskluzive
Profile
Skandaloze

Ekonomi

Prodhime Vendore
Financa
Biznes

Sport

Botërori 2026
Futboll
Basketboll
Sporte Luftarake
Sporte të tjera

Showbiz

Bota e Yjeve
Modë & Stil
Bukuri dhe kujdes
Të tjera

OP-ED

Analizë
Kolumne
Intervistë

Jetë

Fitnes
Ushqime
Travel
Këshilla
Receta
Dieta
Shëndeti

Kulturë

Film
Muzikë
TV & Radio
Libra
Art & Dizajn
Fotografi
Histori

Tech & Auto

Teknologji
Automjete
Telefona
Internet
Lojëra
Aplikacione

Fun

Qesharake
Kuriozitete
Kuize
Fakte
Të tjera